

KPA vendos me 25 shtator për Donika Prelën



Kolegji i Posaçëm i Apelit do të shpallë vendimin për prokuroren Donika Prela më 25 shtator.

Gjatë seancës së sotme Kolegji dëgjoji përfundimet e Komisionerit Publik, i cili kërkoi shkarkimin e Prelës për shkak se nuk justifikon pasurinë dhe është e paaftë.

Ndërkohë prokurorja Prela kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi argumentoi se pasuria e saj ishte e ligjshme dhe se ajo ishte e aftë.

Donika Prela u konfirmua në detyrë nga shkalla e parë e vetingut, në një nga [vendimet më të debatueshme të KPK-së](#).

Sikurse doli gjatë hetimit të vetingut, Donika Prela ka kryer, me shumë gjasa, evazion fiskal, duke mos paguar taksa për të ardhurat, ka kryer transaksione të dyshimta financiare, me gjasa të paligjshme, duke marrë disa herë hua pa kontratë, me para në dorë dhe nga njerëz që nuk i justifikojnë paratë, ka blerë dy apartamente nën çmimin e tregut dhe i ka shitur me fitim, për të cilin nuk ka paguar asnjëherë taksa.

Në prill 2019, Komisioneri Publik, Florian Ballhysa i kërkoi Kolegjit të Posaçëm të Apelit shkarkimin e saj. Sipas apelit, Prela nuk arrin nivel të besueshëm kryesisht në kriterin e pasurisë.